



Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga Mimoza Tasi kryesuese, Ina Rama relatores, Albana Shtylla, Rezarta Schuetz, Sokol Çomo anëtarë, shpalli vendimin për çështjen nr. 41/2022, datë 22.09.2022, që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Bevis Shehaj kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 541, datë 15.06.2022.

^

Në përfundim të gjykimit në dhomë këshillimi, trupi gjykues, bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe në nenin 50, germa “d” të ligjit 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, me shumicë votash, vendosi:

- Prishjen e vendimit nr. 541, datë 15.06.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Bevis Shehaj dhe pushimin e gjykimit të çështjes.
- Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 03.02.2025.

POSTUAR NGA: NJOFTIME ([HTTPS://KPA.AL/CATEGORY/NJOFTIME/](https://kpa.al/category/njoftime/)), NJOFTIME
([HTTPS://KPA.AL/CATEGORY/NJOFTIME-SQ/](https://kpa.al/category/njoftime-sq/))

< [Njoftim \(https://kpa.al/njoftim-1448/\)](https://kpa.al/njoftim-1448/)

[Njoftim \(https://kpa.al/njoftim-1449/\)](https://kpa.al/njoftim-1449/) >

